



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 600/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Kimete Gashi, Vedat Poterqoi – Anetar, Agon Ramadani - Anetar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "SABA BELCA" Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Sheshit qendror të qytetit - Ritenderim", me nr. të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Rahovecit, me datën 09.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "SABA BELCA" Dega në Kosovë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 31.10.2022 me numër të protokollit 600/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Sheshit qendror të qytetit - Ritenderim", me nr. të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Rahovecit.

II. APROVOHET vendimi i AK lidhur me aktivitetin prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të diapozitivit të këtij Vendimi. "Ndërtimi i Sheshit qendror të qytetit - Ritenderim", me nr. të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Rahovecit.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues refuzohete bazuar, bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 12.10.2022, Autoriteti Kontraktues -, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Sheshit qendror të qytetit - Ritenderim”, me nr. të prokurimit: 623-22-6778-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna e Rahovecit.

Me datën 17.10.2022 OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me vendim të datës 19.10.2022.

Me datën 19.10.2022 OE “SABA BELCA” Dega në Kosovë ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoli: 600/22), kundër njoftimit për dhënie për kontratë të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105. të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 14.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;

Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit;

Përgjigje në pretendimin nr.1

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të vendosura nga AK -KK- Rahovec në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e kësaj dosje sqaron si në vijim: Pas analizimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik *LULZIM BEQIRAJ BI & FIDANI-BETON SHPK & EAE - NJAZ SHPK*, saktësisht Letër Përkrahja lëshuar nga NLB Bankë me datën 09/ 09/2022. Mbështetur mbi anën faktike të dokumentit në fjalë dhe kriterëve të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit konsideroj që AK- ka vepruar në kundërshtim më me nenin 59 të LPP- së dhe nenin 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve të RRUOPP-së pika 41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së. Ky dokument nuk përmbush kriteret e vendosura nga AK- Komuna Rahovec, **pretendimi ankimor i OE-së ankues është i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin nr.2

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e kësaj dosje sqaron se, pretendimi ankimor i OE-së ankues **është i pa bazuar** dhe si i tillë është i pa pranueshëm sepse sipas rregullave ligjore nuk obligohen OE të nënshkruaj paramasën dhe parallogarinë pasi që i njëjti dokument është në e-prokurim.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit i cili është pjesë e kësaj dosje sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe Rregulloren B57 “Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulet”, AK është dashur të kërkoj sqarim lidhur me këtë çështje, **pretendimi ankimor i OE-së ankues është i bazuar**.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si **pjesërisht e bazuar**, ndërsa njoftimi B58- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datë 12.10.2022 të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç’rast OE ankues është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues. AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritator të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimet Ankimore ndaj Grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë :

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të vendosura nga AK -KK- Rahovec në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit.

PSH lidhur me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke pretenduar se GOE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret sipas DT saktësisht lidhur me Letër Referencën e lëshuar nga PCB në Prizren në të cilën thuhet se nëse klienti kërkon mbështetje financiare për projektin në fjalë atëherë PCB do të konsiderojë mbështetjen financiare prej 150,000.00 Euro duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar pas analizës financiare të bërë nga Këshilltarët e klientëve për biznes.

PSH pas shqyrtimit të kësaj shkrese sa i përket këtij pretendimi ankimor të parashtruar nga OE ankues, me datë 01.12.2022 i është drejtuar bankës e cila ka lëshuar këtë Letër Referece duke i kërkuar sqarime :

Oshp i është drejtuar bankese me Kerkese per sqarim lidhur me Leter Reference per operatorin ekonomik Famis Co duke Kerkuar cituar:nga ju nje konfirmim se ky document a paraqet mbeshtje nga banka ose akses ne kredi nga banka ne vlere se paku 150,000.00 euro apo nuk paraqet mbeshtje per projektin ne fjale. Kurse banka, Ju konfirmojmë se nese klienti ynë “Famis Co” do të jetë fitues i projektit në fjalë, banka jonë do ta mbështesë me finansim në vlerë prej 150,000.00 EUR nese klienti na drejtohet me kërkesë të tillë

Bazuar në sqarimin e dhënë nga banka e cila ka lëshuar këtë rekomandim, PSH konstaton se pretendimi i parë kundër OE të rekomanduar është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të dytë të parashtruar nga OE ankues, PSH ia falë besimin përgjigjes së ekspertit të dhënë në raportin e ekspertizës si të tillë është pretendim i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të tretë të parashtruar nga OE ankues i cili pretendon se GOE i rekomanduar ka dorëzuar ofertë me çmime të cilat i ka klasifikuar si tender jo normalisht të ulët në të cilin pretendim OE ankues i përmend disa pozicione (1.4,3.1,3.2,3.3,3.4,3.9,7.2, tek Punë Ndërtimore – Sheshi Qendror si dhe pozicionin 2.6 tek Eklektrika – Sheshi qendror), PSH konstaton se sipas rregullores për çmime jo-normalisht të ulëta “Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët”- neni 3.1 par. II i këtij rregulli lidhur me nenin 61 të LPP, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ofertat e dorëzuara nga Operatorët Ekonomik nuk kanë plotësuar kriteret sipas kësaj rregullore, andaj PSH vlerëson se pretendimi i parashtruar nga OE ankues nuk është i bazuar.

Të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga OE ankues edhe për operatorët tjerë ekonomik të cilët janë të pasukseshëm në këtë aktivitet të prokurimit , PSH nuk është lëshuar në trajtimin e tyre për shkak se si të tilla nuk ndryshojnë gjendjen faktike të precizuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Paneli shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesuese e Panelit e Shqyrtues

Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal Rahovec;
- 1x1 OE- “SABA BELCA” Dega në Kosovë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.